



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

Regulativni Autoritet Železnica

Railëay Regulatory Authority

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKAKOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO  
AUTORITETI RREGULLATIV I HEKURUDHAVE  
REGULATIVNI AUTORITET ŽELEZNICA  
RAILWAY REGULATORY AUTHORITY

DEP/SEK.  
DEP/SEK.  
DEP/SEK.

NR. PROT.  
BR.PROT.  
NR.PROT.

01 146

NUMRI I FAQEVE  
06  
01 OF PAGES

DD.MM.YYYY.  
13.07.2021

PRISHTINA/A  
REGULATIVNI AUTORITET - EKURUDHATE - RAILWAY REGULATORY AUTHORITY

Ne mbështetje te nenit 38, paragrafi 2, te Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, Bordi i Autoritetit Rregullativ te Hekurudhave miraton:

**Rregullore me Nr. 02/2021 për Mbikëqyrje, Monitorim dhe Inspektim**

Rr. Rrustem Statovci nr.29  
Prishtinë, Kosovë  
Tel:+381 38 22 00 40  
Fax:+381 38 22 33 40  
Web:[www.arh-ks.org](http://www.arh-ks.org)

Kuvendi i Kosovës  
Skupština Kosova  
Assembly of Kosovo

## Neni 1

### Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregullore është mbikëqyrja, monitorimi dhe inspektimi i linjave hekurudhore, mjeteve lëvizëse hekurudhore, ndërmarrjeve hekurudhore dhe menaxherit të infrastrukturës, te cilat janë bartës te licencave, certifikatave/autorizimeve të sigurisë, regjistrat NVR, shenjëzimit VKM, të mjeteve lëvizëse hekurudhore, të drejtat e udhëtarëve si dhe të drejta tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore, të lëshuara nga Autoriteti Rregulativ i Hekurudhave (ne tekstin e mëtejme ARH) dhe institucionet tjera kompetente.

## Neni 2

### Fushëveprimi

2.1 Kjo Rregullore zbatohet nga ARH për mbikëqyrjen, monitorimin dhe inspektimin e licencave, certifikatave/autorizimeve të sigurisë, regjistrat NVR, shenjëzimit VKM të mjeteve lëvizëse, të drejtat e udhëtarëve si dhe të drejta tjera të përcaktuara sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës si dhe akteve nënligjore.

2.2 Kjo Rregullore zbatohet edhe për subjektet tjera të cilat shfrytëzojnë rrjetin hekurudhor brenda territorit të Kosovës.

2.3 Mbikëqyrja, monitorimi dhe inspektimi, kryhet nga ARH-ja me qëllim që të sigurohet operimi hekurudhor në pajtueshmëri me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi.

## Neni 3

### Përkufizimet

3.1 **ARH** - institucion i pavarur i cili është i ngarkuar për rregullimin, mbikëqyrjen, organizimin e sektorit hekurudhor në Kosovë dhe i cili vepron si organ licensues, organ përgjegjës për çështjet e interoperabilitetit dhe entiteteve të njoftimit, organ për rregullimin e tregut hekurudhor dhe organ për sigurinë hekurudhore dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të këtij ligji;

3.2 **Mbikëqyrja** - proces i veprimeve dhe verifikimit të fakteve të konstatuara nga ana e ARH-së, për të garantuar dhe siguruar që pala e inspektuar, ushton aktivitetin e saj në përputhje me legiislacionin në fuqi;

3.3 **Monitorimi**- proces i vlerësimit, rishikimit dhe shqyrtimit të informacioneve të mbledhura

në tregun e sektorit hekurudhor;

3.4 **Inspektimi**- kontrollet me qëllim të përcaktimit të pajtueshmërisë së aktiviteteve dhe praktikave të palës së inspektuar (kontrolluar) me dispozitat e legjislacionit relevant;

3.5 **Inspektor/zyrtar** - personi/personat e caktuar/ngarkuar për inspektim (kontroll), në pajtim me dispozitat e legjislacionit aktual;

3.6 **NVR** - regjistri nacional i mjeteve lëvizëse (NVR) është bazë e të dhënave të numrave unik dhe të dhënave të tjera të menaxhimit dhe sigurisë për të gjitha mjetet hekurudhore që operojnë në Kosovë;

3.7 **VKM** - kod unik alfa-numerik i përbërë nga 2 deri në 5 shkronja, i cili emërtón mbajtësin e mjeteve, ashtu siç është regjistruar në regjistrin e mjeteve lëvizëse NVR;

3.8 **Lizencë hekurudhore** - dokumenti i cili zyrtarisht njeh aftësinë e menaxherit të infrastrukturës, ndërmarrjes hekurudhore si dhe makinit, për të kryer shërbimet e transportit në hekurudhë;

3.9 **Autorizimi**- dokumenti me të cilin menaxheri i infrastrukturës dëshmon se plotëson kushtet për ofrimin e shërbimeve infrastrukturore të sigurta;

3.10 **Certifikata e sigurisë**- dokumenti me anë të së cilit ndërmarrja hekurudhore dëshmon se i përmbrush kushtet për trafik të sigurt në linja specifike hekurudhore apo në tërë rrjetet hekurudhore;

3.11 **Makinisti** - personi i aftë dhe i autorizuar për të drejtuar trenat duke përfshirë lokomotivat, lokomotivat manovruese, trenat punues, mjetet lëvizëse të mirëmbajtjes, apo trenat për bartjen e udhëtarëve dhe mallrave në hekurudhë në mënyrë autonome, të përgjegjshme dhe të sigurt;

3.12 **Ndërmarrja hekurudhore** – cila do ndërmarrje publike apo private, biznesi kryesor i së cilës është ofrimi i shërbimeve të transportit hekurudhor për mallrat dhe/ ose udhëtarët me kërkesën që ndërmarrja duhet të siguroj tërheqjen; kjo gjithashtu përfshinë edhe ndërmarrjet të cilat ofrojnë vetëm shërbimet e tërheqjes;

3.13 **Menaxheri i infrastrukturës hekurudhore** – njësia organizative që është përgjegjëse për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe operimin e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duke përfshirë dhënien e trasesë së trenit dhe kërkimin e pagesës për atë shfrytëzim e gjithashtu edhe negullimin e trafikut, funksionet e përmendura të menaxhimit të infrastrukturës i atribuohen më shumë se sa vetëm një njësie organizative.

#### Neni 4

#### Autorizimi i Mbikëqyrjes, Inspektimeve dhe Monitorimit

Organet që veprojnë në kuadër të ARH-së, janë të autorizuara për mbikëqyrje, monitorim dhe inspektim, me Ligjin për Hekurudhat dhe ketë rregullore, në raport me ndërmarrjet hekurudhore dhe menaxherin e infrastrukturës për të sigruar pajtueshmërinë e obligimeve të tyre ligjore.

#### Neni 5

#### Forma dhe mënyra e mbikëqyrjes, monitorimit dhe inspektimit

5.1 Mbikëqyrja, monitorimi dhe inspektimi i ndërmarrjeve hekurudhore dhe menaxherit të infrastrukturës bëhet nga inspektorët/zyrtarët e departamenteve përkatëse apo bashkërisht nga disa organe brenda ARH-së.

5.2 Mbikëqyrja, monitorimi dhe inspektimi mund të bëhet në të gjitha hapësirat që janë në pronësi dhe shfrytëzim të ndërmarrjeve hekurudhore dhe menaxherit të infrastrukturës.

5.3 Në disa raste, kjo formë e mbikëqyrjes, monitorimit dhe inspektimit mund të bëhet me paralajmërim dhe koordinim paraprak mes ARH-së, ndërmarrjeve hekurudhore dhe menaxherit të infrastrukturës.

5.4 Inspektorët/zyrtarët e ARH-së mund të bëjnë mbikëqyrje, monitorim dhe inspektim edhe pa paralajmërimi në mënyrë që të sigurohen se ndërmarrjet hekurudhore dhe menaxheri i infrastrukturës janë duke i përbushur obligimet e tyre ligjore.

#### Neni 6

#### Përgjegjësitë dhe detyrat e ndërmarrjeve hekurudhore dhe menaxherit të infrastrukturës

6. 1 Ndërmarrjet hekurudhore dhe menaxheri infrastrukturës në procesin e mbikëqyrjes, monitorimit dhe inspektimit, kanë përgjegjësitë e tyre si vijon:

1.1. Të sigurojnë kushtet e përshtatshme për mbikëqyrje, monitorim dhe inspektim;

1.2 Të sigurojnë të gjitha dokumentet e nevojshme dhe të kërkua nga zyrtarët/inspektorët;

1.3 Të ofrohet qasje në mbikëqyrjen, monitorimin dhe inspektimin e të gjitha mjeteve lëvizëse, infrastrukturën hekurudhore dhe hapsira tjera në pronësi dhe shfrytëzim të tyre;

1.4 Të ofrojnë asistencë teknike për mbikëqyrje, monitorim dhe inspektim.

#### Neni 7

##### **Mbikëqyrja, monitorimi dhe inspektimet e jashtëzakonshme**

7.1 Kur ka informacione apo dyshohet se ndërmarrja hekurudhore apo menaxheri infrastrukturës është duke kryer veprimtari në kundërshtim me obligimet e tyre ligjore, ARH-ja ka të drejtë të bëjë mbikëqyrje, monitorim dhe inspektimet e jashtëzakonshme.

7.2 Në këto situata të jashtëzakonshme, mund të shmangën procedurat standarde, çka nënkupton se mbikëqyrja, monitorimi dhe inspektimi mund të bëhet edhe jashtë orarit të punës dhe në bazë të kërkesës së eprorëve, ku këta të fundit duhet të marrin informacionet e nevojshme sa më parë që është e mundur.

7.3 Mbikëqyrjet, monitorimet dhe inspektimet e jashtëzakonshme, nga ana e Departamenteve të ARH-së, mund të kryhen me inicim nga ana e Bordit të ARH-së, Drejtorit të Përgjithshëm, Drejtorit të departamentit si dhe organeve të rendit.

#### Neni 8

##### **Procesverbal i inspektimit, monitorimit dhe mbikëqyrjes**

8.1 Inspektorët/zyrtarët duhet të mbajnë shënimë në formë të procesverbalit gjatë kryerjes së inspektimit, monitorimit dhe mbikëqyrjes.

8.2 Pas përfundimit të inspektimit, monitorimit dhe mbikëqyrjes, inspektori/zyrtari dorëzon procesverbalin më të gjeturat dhe rekomandimin për vendim final tek drejtori përkatës, në rast të evidentimit te shkeljeve ligjore nga ana e subjekteve të inspektuara, monitoruara dhe të mbikëqyrura.

8.3 Nëse gjatë inspektimit, monitorimit dhe mbikëqyrjes, nuk evidentohen shkelje, procesverbal i dorëzohet vetëm si formë njoftimi tek drejtori.

8.4 Prosesverbal, sipas paragrafit 2 të po këtij neni, duhet të dorëzohet tek drejtori përkatës, jo më vonë së 7 ditë, pas përfundimit të inspektimit, monitorimit apo mbikëqyrjes.

#### Neni 9

##### **Mbikëqyrja, monitorimi dhe inspektimet e rregullta vjetore**

9.1 ARH realizon mbikëqyrje, monitorime dhe inspektimet e rregullta vjetore. Raporti vjetor i mbikëqyrjes, monitorimit dhe inspektimeve, paraqet përshkrimin e gjendjes faktike, të

gjeturat, konkluzionet dhe rekomandimet.

9.2 Ky draft-raport, para finalizimit, ju dërgohet palëve për komentim në një afat jo më të gjatë se 15 ditë.

9.3 Pas finalizimit, i njëjti i dërgohet Drejtorit të Përgjithshëm, ndërmarrjeve hekurudhore dhe menaxherit të infrastrukturës.

#### Neni 10

#### Gjobat Administrative

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, monitorimit ose inspektimit, në rast se inspektorët/zyrtarët, evidentojnë shkelje ligjore nga ndërmarrja hekurudhore apo menaxheri infrastrukturës, rekòmandimin për shqiptim të gjobës, bazuar në Rregulloren e ARH-së për Taksa dhe Gjoba e shqipton departamenti përkatës, jo më larg se 30 ditë nga pranimi i procesverbalit, i cili më pastaj dërgohet tek ndërmarrja apo menaxheri infrastrukturës.

#### Neni 11

#### Shqyrtimi i Ankesave

- 11.1 Pala ndaj të cilave është shqiptuar gjoba, ka të drejtë që të paraqesë ankesë ndaj vendimeve që merren në bazë të kësaj rregullore.
- 11.2 Ankesa i drejtohet Bordit të ARH-së për shqyrtim në afat prej 15 ditësh pas marjes së vendimit të shqiptimit të gjobës.
- 11.3 Përgjigjen ndaj ankesës, sipas këtij neni, Bordi duhet ta jep në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të ankesës.
- 11.4 Në mungesë të Bordit për shkak të mandatit, shqyrtimi i ankesës bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së.


#### Neni 12

#### Subjektet tjera

Mbikëqyrja, monitorimi, inspektimi dhe përgjegjësitë e parapara me këtë rregullore për ndërmarrje hekurudhore dhe menaxher të infrastrukturës, vleinë në mënyrë analoge edhe në raport me të gjitha subjektet tjera që shfrytëzojnë rrjetin hekurudhor brenda territorit të Kosovës.

Neni 13  
Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj.



Prishtinë dt:13.07.2021.